

NDREQJE GABIMI

Në “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 127, datë 12.7.2016:

- Neni 2 “Qëllimi i rregullores”

Ishte: “Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë procedura transparente në ushtrimin e funksioneve të ERE-s, duke garantuar një trajtim të barabartë në dhënien e licencave, kualifikimeve dhe certifikimeve në sektorin e energjisë elektrike, vendosjen e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në aktivitetet e rregulluara, zgjidhjes së konflikteve midis të licencuarve dhe midis të licencuarve dhe klientëve, hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”,

Bëhet: “Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë procedura transparente në ushtrimin e funksioneve të ERE-s, duke garantuar një trajtim të barabartë në dhënien e licencave dhe certifikimeve në sektorin e energjisë elektrike, vendosjen e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në aktivitetet e rregulluara, zgjidhjes së konflikteve midis të licencuarve dhe midis të licencuarve dhe klientëve, hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Neni 3 “Zbatimi”, pika 1, germa “b”:

Ishte: “trajtimin e aplikimeve për dhënie licence, kualifikim dhe certifikim në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror,”

Bëhet: “trajtimin e aplikimeve për dhënie licence dhe certifikim në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror,”

- Neni 16 “Ridëgjimi dhe ankimi kundër vendimit të Bordit”, pika 1:

Ishte: “Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes dijeni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.”

Bëhet: “Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara”.

- Neni 18 “Regjistrimi i aplikimit apo kërkesës”, pika 1:

Ishte: “Punonjësi i protokollit hap një dosje për çdo procedurë, për të cilën këto rregulla janë të aplikueshme, përfshirë ankesat, kërkesat, procedurat e tarifave, çmimeve, licencave, kualifikimeve, certifikimeve dhe relacionet argumentuese në lidhje me një amendament, shtojcë, përfundim, rinovim, heqje të licencës etj. Çdo procedim do të ketë një numër të caktuar në regjistrin e protokollit dhe do t’i bashkëlidhet kartelës shoqëruese, siç përcaktohet në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ERE-s”. Për dokumente të të njëjtit procedim krijohet dosja përkatëse nga zyra e protokollit në bashkëpunim me drejtoritë e ngarkuara për trajtimin e kërkesës apo aplikimit. Punonjësi i protokollit mban një listë për të gjitha procedurat e futura në dosje dhe siguron një kopje të kësaj liste falas për të gjitha palët, përfshirë personat e interesuar që e kërkojnë atë.

Bëhet: “Punonjësi i protokollit hap një dosje për çdo procedurë, për të cilën këto rregulla janë të aplikueshme, përfshirë ankesat, kërkesat, procedurat e tarifave, çmimeve, licencave, certifikimeve dhe relacionet argumentuese në lidhje me një amendament, shtojcë, përfundim, rinovim, heqje të licencës etj. Çdo procedim do të ketë një numër të caktuar në regjistrin e protokollit dhe do t’i bashkëlidhet kartelës shoqëruese, siç përcaktohet në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ERE-s”. Për dokumente të të njëjtit procedim krijohet dosja përkatëse nga zyra e protokollit në bashkëpunim me drejtoritë e ngarkuara për trajtimin e kërkesës apo aplikimit. Punonjësi i protokollit mban një listë për të gjitha procedurat e futura në dosje dhe siguron një kopje të kësaj liste falas për të gjitha palët, përfshirë personat e interesuar që e kërkojnë atë.”

- Neni 19 “Fillimi i procedurës”, pika 1, germa “d”:

Ishte: “kualifikim dhe dhënie të certifikatës së origjinës së prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë.”

Bëhet: “dhënie të certifikatës së origjinës së prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë.”